



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1887/prot.
/1

Tiranë, më 18.04.2020

URDHËR

Nr. 263, datë 18.04.20
/1

PËR

**DISA SHTESA NË URDHRIN NR.263, DATË 17.4.2020, "PËR
PËRCAKTIMIN E ORAREVE TË LËVIZJES PËR KËMBËSORËT
PENSIONISTË, TË SËMURËVE KRONIKË NË TRAJTIM MJEKËSOR
DHE TË RREGULLAVE PËR LËVIZJEN ME MJETE PRIVATE"**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.263, datë 17.4.2020, "Për përcaktimin e orareve të lëvizjes për këmbësorët pensionistë, të sëmurëve kronikë në trajtim mjekësor dhe të rregullave për lëvizjen me mjete private", bëhen këto shtesa:

1. Në titullin e urdhrin, pas fjalës "... pensionistë ..." shtohen fjalët "... nënat me fëmijë ...".
2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Lejohet lëvizja e nënave me fëmijë deri në moshën 10 (dhjetë) vjeç, ditën e diel, datë 19.4.2020, deri në orën 11.00, të pashoqëruar me persona të tjerë në krah.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

